

“Themelues madhor i Ortodoksisë në Shqipëri”/ Mitsotakis: Kryepiskopi Anastas, diplomat i dashurisë



Kryeministri i Greqisë, Kyriakos Mitsotakis, në fjalën e tij gjatë ceremonisë mortore të Kryepiskopit Anastas, u shpreh se ai ishte themelues madhor i Ortodoksërisë në Shqipëri dhe diplomat i dashurisë.

“Kryepiskopi Anastas Janullatos ishte themelues madhor i ortodoksisë në Shqipëri. Figura e tij do të jetë e pazëvendësueshme edhe këtu edhe në zemrën e helenizmit. Përulemi me nderim para kontributit të tij. Kryepiskopi Anastas ishte shembull i urtësisë, por edhe i veprimit, dritës e ortodoksisë. Nuk është rastësi që sot e vajtojnë edhe grekët dhe shqiptarët, por edhe besimtarët në botë Ansastas Janullatos, diplomatin e dashurisë.

Kryepiskopi Anastas ishte burim krenarie, shërbëtor i palodhur. Me përulësinë e tij tregoi se Kisha Ortodokse mund të jetë dashuri që bashkon”, tha Mitsotakis.

cna.al